REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. DPK
Nr. Prot 03-02/3324/17
Broj stranica 02
Date 17.10.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.10.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK–03-02-2521/17, për z. Levent Bus, Zëvendës Kryesues i Kuvendit Komunal në Prizren, për shkak se zyrtari i lartë e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Levent Bus, Zëvendës Kryesues i Kuvendit Komunal në Prizren, dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar), në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Gjatë këtij takimi zyrtari i lartë është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në biznes privat, neni 15 (paragrafi 1), të Ligjit nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Prandaj, nga zyrtari i lartë është kërkuar të heq dorë nga ushtrimi i funksionit menaxherial apo të mbyllë biznesin privat me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë është deklaruar se biznesi në fjalë nuk zhvillon aktivitet, andaj brenda afatit ligjor do ta mbyllë biznesin privat.

Ndërkohë, zyrtari i lartë ka sjellë në Agjenci shkresën zyrtare (DPKI.03-02/2857/17) me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë ka bërë shuarje vullnetare të biznesit privat D.P.T "Nida Medical". Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit